



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE

URDHER

Nr. 972 Date 14.12.2007

PËR NDRYSHIME NE STATUTIN E SHOQERISE ANONIME
" UJESJELLES" POLIÇAN SH.A

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 " Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare" ndryshuar me Dekretin Nr. 1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me Dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, VKM 678, date 03.10.2007 dhe nenit 128 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", me cilësinë e aksionerit te vetëm

URDHEROJ :

1.Ndryshimin e statutit te shoqerise "Ujesjellesi" Poliçan, sh.a si me poshte:

Neni 7, pika 3 ndryshon si me poshte:

Aksionet zotërohen ne masen 78.35 % nga Bashkia Poliçan, 20.83% nga Komuna Bogove dhe 0.82% nga Komuna Vendreshe, si perfaqesues te pronarit. Kjo e drejte ju kalohet me vendimin nr. 660 date 12.9.2007 "Për transferimin e aksioneve te shoqërive te ujesjellesve dhe kanalizimeve njesive te qeverisjes vendore".

2.Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit" Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36.

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.



REPublika e Shqipërisë
UJËSjELLËSI POLIÇAN
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Nr. 32 Prot

Polican, me 03/10/2016

VENDIM

NR. 32 Datë 03/10/2016

"PER EMERIMIN E KESHILLIT TE ADMINISTRIMIT TE SHOQERISE SE UJESJELLESIT SH.A POLICAN "

Ne zbatim te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per shoqerit Tregtare" me ndryshimet perkatese, Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.63 date 21.7.2016 "Per riorganizimin e operatorëve qe ofrojne shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave Të ndotura", Ligjit nr.139/2015 "Per vetqeverisjen vendore",

VENDOSA:

- Te krijohet keshilli i administrimit prane Shoqerise se Ujesjellesit Sh.A Polican me perberje :
 - Znj. Bernarda Kondi e diplomuar ne studimet e larta universitare dhe zoteruese e diplomës në shkencat ekonomike .
 - Znj.Luljeta Xhaja e diplomuar ne studimet e larta universitare dhe zoteruese e diplomës DIND në shkencen juridike me eksperience pune 6 (gjashte)vjet .
- Ne zbatim te pikes 2 te nenit 12 te VKM nr.63 dt 21.7.2016 ne perberje te KA eshte dhe Administratori i shoqerise se Ujesjellesit Sh.A Polican Z. Klajd Brahimi.
- Antaret e Keshillit te Administrimit emërohen me mandat 3 (tre) vjecare me te drejte rizgjedhje , me kontratë pune bazuar ne kriteret e qarta performance qe pritet të arrijë cdo anëtar i Keshillit të Administrimit në terma vjetorë sipas Objektivave për performancën (indiktorët) te vendosur në kontratë.
- Paga bruto e antareve te Keshillit te Administrimit do te jete ne vleren 40 000 (Dyzete mije leke/muaj).
- Marredheniet juridike dhe financiare ne zbatim te ketij vendimi fillojne me date 03.10.2016.
- Me ndjekjen e procedurave ligjore per kryerjen e veprimeve prane sporteleve te QKR-se ngarkohet administratori i shoqerise, dhe drejtoria juridike dhe menaxhimit te burimeve njezore prane bashkise Polican.
- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere dhe i shtrin efektet financiare me date 03.10.2016.

KRYETARI I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME
KRYETARI BASHKISE
ADRIATIK ZOTKAJ



REPublika e Shqipërisë
UJËSjELLËS POLIÇAN SH.A
ASAMBLEJA E PËRGJITHËSHME

Nr. 34 Prot

Polican me 30.09.2016

VENDIM

Nr. 34 Date 30/09/2016

"PËR SHKARKIMIN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË UJËSjELLËS POLIÇAN SH.A"

Në zbatim të ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" me ndryshimet përkatëse, vendimin e këshillit të ministrave nr.63 dt. 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, Ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore"

VENDOSA:

- Të shkarkohen antarët e këshillit mbikëqyrës pranë Ujësullës Polican Sh.A me përbërjen si më poshtë:
 - Memli Kasapi, Kryetar i këshillit mbikëqyrës
 - Luljeta Xhaja, Zv/Kryetare e këshillit mbikëqyrës
 - Mimoza Llapë, Antare e këshillit mbikëqyrës
 - Refat Braho, Antar i këshillit mbikëqyrës
 - Fadil Kapllani, Antar i këshillit mbikëqyrës
 - Erjon Zylyflari, Antar i këshillit mbikëqyrës
- Me ndjekjen e procedurave ligjore për kryerjen e veprimeve pranë sporteleve të QKR-së ngarkohet administratori i shoqërisë.
- Ky vendim hynë në fuqi menjehere.

KRYETARI I ASAMBLESE SE PERGJITHËSHME
ADRIATIK ZOTKAJ



REPublika e Shqipërisë
UJËSjELLËSI POLIÇAN
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Nr. 38 Prot

Polican, me 03.10.2016

VENDIM

NR. 38 Datë 03.10.2016

"PER MIRATIMIN E STATUTIT TIP TE SHOQERISE SE UJESJELLESIT SH.A POLICAN "

Ne zbatim te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per shoqerit Tregtare" me ndryshimet perkatese, Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.63 date 27.1.2016 "Per riorganizimin e operatorëve qe ofrojne shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave Të ndotura", Ligjit nr.139/2015 "Per vetqeverisjen vendore" me cilesin e kryetarit te e asambles se pergjithshme ne mbledhjen e radhes se asambles se pergjithshme ne kuader te riorganizimit te ujesjellesit Sh.a Polican

VENDOSA:

- Te miratoj Statutin Tip te Shoqerise se Ujesjellesit Sh.A Polican ne permbajtje dhe forme konforme Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.63 date 27.01.2016 .
- Per zbatimin e ketij statuti ngarkohet asambleja e pergjithshme, keshilli administrimit, eksperti kontabel, administratori i shoqerise se bashku me stafin e shoqerise.
- Statuti i shoqerise i bashkelidhet ketij vendimi ne numer total 13 flete .
- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere .

KRYETARI I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME
KRYETARI BASHKISE
ADRIATIK ZOTKAJ

